

Njoftim aplikimi për bursë

Rektorati i Universitetit "A Xhuvani", Elbasan

Mbështetur në VKM Nr. 710, datë 29.10.2014 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në Institucionet Arsimore Publike, për vitin shkollor 2014 - 2015",

Njofton:

A. Studentët e viteve të para, cikli i parë bachelor, me kohë të plotë të gjitha programeve të studimit të Universitetit "A Xhuvani" Elbasan për fitojnë bursë nga njësitë e qeverisjes vendore (BASHKI - Qytet / KOMUNA - Fshat) ku kanë vendbanimin e tyre. Në rast se kanë përfituar bursë prej tyre të paraqesin pranë **Rektoratit të Universitetit** deri më **31.12.2014** këto dokumente:

1. Vërtetimin që janë studentë në këtë Universitet – *lëshuar nga sekretaria mësimore e fakultetit.*
2. Dokumentin e bankës për hapje numër llogarie – *vetëm pranë Raiffeisen Bank*
3. Kartë identiteti e studentit - fotokopje

B. Studentët e viteve II – ta e të III – ta në të gjitha programet e studimit, të cilët kanë qenë trajtuar me bursë një vit më parë, si dhe ata që kërkojnë të përfitojnë nga bursat e ndërmjetme në dispozicion të Universitetit, të dorëzojnë këto dokumente:

• Për studentët me banim në Komuna/ Fshat

1. Vërtetim që janë studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan – *lëshuar nga sekretaritet mësimore.*
2. Certifikatë familjare – *originale, lëshuar brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të dokumentacionit nga Zyra e Gjendjes Civile.*
3. Vërtetim në emër të kryefamiljarit për trajtimin e familjes së tij me ndihmë ekonomike si familje në nevojë, ku të specifikohet: numri i dosjes dhe numri i frymëve që përfitojnë ndihmë, masa e ndihmës (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) – *lëshuar nga Komuna. Mos dorëzimi i dokumentit sipas të dhënave të kërkuara përbën shkak për skualifikim.*
4. Dokumentin e bankës për hapje numër llogarie – *vetëm pranë Raiffeisen Bank*
5. Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

• Për studentët me banim në Bashki / Qytet

1. Vërtetim që janë studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan – *lëshuar nga sekretaritet mësimore.*
2. Certifikatë familjare – *originale, e lëshuar brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të dokumentacionit nga Zyra e Gjendjes Civile.*
3. Vërtetim në emër të kryefamiljarit për trajtimin e familjes së tij me ndihmë ekonomike si familje në nevojë, ku të specifikohet: numri i dosjes dhe numri i frymëve që përfitojnë ndihmë, masa e ndihmës (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) – *lëshuar nga Bashkia. Mos dorëzimi i dokumentit sipas të dhënave të kërkuara përbën shkak për skualifikim.*
4. Dokumentin e bankës për hapje numër llogarie – *vetëm pranë Raiffeisen Bank.*
5. Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

Në qoftë se familja (trungu familjar) nuk merr ndihmë ekonomike si familje në nevojë, të dorëzohen edhe këto dokumente:

1. Vërtetim për pjesëtarët e trungut familjar në moshë pune, që janë të regjistruar si punëkërkuar te papunë – *lëshuar nga DR Punësimi të Qarkut.*
2. Vërtetim për pjesëtarët e trungut familjar që kanë ose jo aktivitet privat – *lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave e Qarkut.*
3. Vërtetim për pjesëtarët e trungut familjar që kanë ose jo automjet – *lëshuar nga D.P.SH.T.RR. (Drejtoria Rajonale e qarkut përkatës).*
4. Vërtetim për pjesëtarët e trungut familjar që përfitojnë ose jo të ardhura nga Buxheti i Shtetit – *lëshuar nga DRS Shoqërore e Qarkut.*

• Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të mësipërme për kriterin ekonomik të dorëzohen edhe këto dokumente:

1. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit – *dokumentin e statusit të jetimit (fotokopje e noterizuar),*
2. Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë - *vendim gjykate (fotokopje e noterizuar),*
3. Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë – *certifikatë familjare dhe vërtetim që banon në konvikt publik,*
4. Studenti, që ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik - *dokumentin përkatës (fotokopje e noterizuar)*

• Sipas rezultateve të arritura

- a. Studentët e programit të studimit "Matematikë – fizikë", të vitit të dytë e lartë dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 – të
- b. Studentët e programeve të tjera të studimit, të vitit të dytë e lartë dhe që kanë përfunduar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 – a
- c. Studentët që regjistrohen vitin e parë e që janë shpallur nga MASH më të mirët e maturës shtetërore – afishimi bëhet nga MASH

Të paraqesin pranë Rektoratit të Universitetit deri më **15.11.2014** këto dokumente:

1. Vërtetimin për rezultatet – *lëshuar nga sekretaria mësimore e fakultetit.*
2. Dokumentin e bankës për hapje numër llogarie – *vetëm pranë Raiffeisen Bank*
3. Kartë identiteti e studentit - fotokopje

• Jashtë kriterit ekonomik

Studenti fëmijë i punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës të paraqesin pranë **Rektoratit të Universitetit** deri më **15.11.2014** këto dokumente:

1. Vërtetimin për statusin – *fotokopje e noterizuar*
2. Vërtetim që janë studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan – *lëshuar nga sekretaritet mësimore.*
4. Dokumentin e bankës për hapje numër llogarie – *vetëm pranë Raiffeisen Bank*
5. Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

• Nuk përfitojnë bursë studentët që:

- Janë me banim në Bashkinë Elbasan (pika 2.1. a) e VKM – së më lart)
- Janë me banim në fshat dhe familja nuk trajtohet me ndihmë ekonomike
- Figurojnë në Gjendje Civile të ndarë nga trungu familjar
- Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private
- Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi
- Shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jo kaluese.

C. Dokumentacioni i përgatitur dhe i renditur sipas formularit të Aplikimit për bursë të dorëzohet nga vetë studentit në Rektorat – protokollit, nga data

03.11.2014 - 15.11.2014 ora 12.⁰⁰ - 15.⁰⁰

Formulari i Aplikimit për bursë shkarkohet nga faqja zyrtare e Universitetit "A. Xhuvani" Elbasan : www.uniel.edu.al

Njoftimi është i publikuar në adresën: www.uniel.edu.al